



Datë: 24.11.2025  
Numër Protokolli: 7546/2025

A.nr.1826/2025

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtarë, me Hava Fekaj Zyrtare e Lartë për Inspektim Administrativ - në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës A.nr.1826/2025, të datës 22.10.2025, të parashtruar nga ankuesi, A.H, kundër organit të punësimit: Agjencia Kosovare për Krahassim dhe Verifikim të Pronës, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3, nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 24.11.2025, mori këtë:

## V E N D I M

**Hedhet poshtë si e parakohshme** ankesa me numër A.nr.1826/2025, të datës 22.10.2025, të parashtruar nga ankuesi, A.H.

## A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbim civil, A.H (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), me datë 05.12.2024, ka parashtruar ankesë me numër protokolli 6927/2025, të regjistruar nën shenjë A.nr.1826/2025, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Njoftimit të datës 17.10.2025, me të cilin i është refuzuar aplikacioni për shkak të arsyetimit se nuk e ka plotësuar kriterin lidhur me përvojën e punës, lidhur me procedurën e rekrutimit sipas konkursit me numër reference RN00018649, për pozitën e punës “*Udhëheqës i Divizionit për Logjistikë*”, në Agjencinë Kosovare për Krahassim dhe Verifikim të Pronës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) nga shqyrtimi dhe analizimi i shkresave të bashkangjitura të lëndës të dërguara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa **është e parakohshme**, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rrjedhë se, Divizioni për Burime Njerëzore në Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës, me datë 27.09.2024, ka publikuar Njoftimin për shpalljen e Konkursit me numër reference RN00018649, për pozitën e punës *“Udhëheqës i Divizionit për Logjistikë”*, në Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës, me afat aplikimi nga data 12.09.2025, deri më datë 11.10.2025.

Rrjedhimisht, sipas shkresave të lëndës rrjedhë se ankuesi ka aplikuar në konkursin e lartpërmendur por sipas Njoftimit të datës 17.10.2025, i është refuzuar aplikacioni për procedurën e rekrutimit sipas konkursit me numër reference RN00018649, për pozitën e punës *“Udhëheqës i Divizionit për Logjistikë”*, në Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës, për shkak se nuk e ka plotësuar kriterin e përvojës së punës sipas kërkesës së konkursit, citoj *„kandidati në aplikimin e tij nuk ka të bashkangjitur dëshmitë e kërkuara sipas pikës 3 dhe 5 të konkursit me numër reference RN00018649, me saktësisht nuk ka bashkangjitur dëshminë lidhur me përvojën e punës sipas kërkesës së konkursit që duhet të jetë përvoja pas diplomimit tri (3) vite përvojë pune profesionale. Kandidati duhet të paraqesë: Kopjet e dëshmisë së punësimit (vërtetim/kontratë) të lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen dhe angazhimin në atë pozitë. Dëshmia e punësimit jashtë institucioneve publike duhet të mbështetet së paku njëra nga dëshmitë si në vijim: pasqyra e pagesave në fondin e kursimeve pensionale apo pasqyra e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personale”*....

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se e ka dorëzuar dokumentacionin e plotë që vërtetojnë përvojën e tij profesionale, përfshirë punën në zyrën e noterit, në kompaninë “Viva Fresh”, si dhe në kompaninë “Baumarket”, ankuesi pretendon se këto përvoja profesionale, sipas përmbajtjes dhe natyrës së punës, janë në përputhje të drejtë për drejtë me detyrat dhe përgjegjësitë që kërkohen për pozitën të cilën ka aplikuar. Ankuesi pretendon se vlerësimi i bërë nga Divizioni për Burime Njerëzore nuk është i drejtë dhe është në kundërshtim me parimet e transparencës dhe barazisë në punësim, të garantuara më Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrarët Publikë, si dhe me Rregulloren (QRK)Nr.15/2023 për procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil.

Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmerinë e ankesës ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrarët Publikë, gjegjësisht nenit 44 paragrafi 10 ku përcaktohet se: 12. *Kandidatët/ët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK sipas afatit të përcaktuar në ligjin përkatës për procedurën administrative*, si dhe nenit 17 të Rregullores Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil, ku përcaktohet se: 17. *Kandidatët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK në afat prej tridhjetë (30) ditëve.*

Referuar kuadrit ligjor përkatës si dhe duke u bazuar në provat e administruara të lëndës, Kolegji i Këshillit konstatoi se ankesa e parashtruar nga ankuesi me datë 22.10.2025, kundër Njoftimit të datës 17.10.2025, me të cilin i është refuzuar, lidhur me procedurën e rekrutimit sipas konkursit me numër reference RN00018649, për pozitën e punës *“Udhëheqës i Divizionit për Logjistikë”*, në Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës, është e parakohshme, ngase sipas dispozitave përkatëse

ligjore, kandidati për pranim në shërbim civil ka të drejtë të parashtroj ankesë vetëm pas përfundimit të procedurës së rekrutimit, ndërsa, në rastin konkret ankuesi ka parashtruar ankesë ende pa përfunduar procedura e rekrutimit me numër reference RN00018649,, e shpallur me datë 11.09.2025 për pozitën “Udhëheqës i Divizionit për Logjistikë”, në Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës.

Andaj, theksuar si më sipër, Kolegji i Këshillit konstaton se ankesa e parashtruar nga ankuesi me datë 22.10.2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pa u publikuar ende rezultatet përfundimtare lidhur me procedurën përkatëse të rekrutimit është e parakohshme në kuptim të dispozitave të nenit 44 paragrafi 10 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, ndërlidhur me nenin 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe se në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, e njëjta është e papranueshme, kështu që, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi të hedhë poshtë si të parakohshme ankesën A.nr.1826/2025, të datës 22.10.2025, siç përcaktohet në dispozitiv të këtij vendimi.

Referuar pretendimit ankimor për qasje në testin me shkrim dhe ese, Kolegji rikujton palën e ankuese që e njëjta në pajtim me Ligjin e aplikueshëm për qasje në dokumentet zyrtarë mund të parashtroj kërkesës pranë organit gjegjes.

**Këshillë juridike:** Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda A.nr.1826/2025**

**Hava FEKAJ**

Procesmbajtëse

**Malsore GASHI-BAJRAKTARI**

Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit A.H;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.